



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Qershor 2021

Nr: 14

U D H Ë Z I M
P Ë R

“PËR CAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUESVE LIGJOR) DHE KUSHTET KONTRAKTUALE PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE GJATË VITIT KALENDARIK DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE KANDIDATËT E TYRE NË FUSHATËN ZGJEDHORE”

Në mbështetje të neneve 19 pikat 1, shkronja “ë”, e 2, 92/6 pika 3, dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 23/2 e 23/3, të ligjit nr.8580 datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, të ndryshuar.

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara:

- nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe,
- nga subjektet zgjedhore (parti politike, koalicione, kandidatë të propozuar nga zgjedhësit) dhe kandidatët e tyre në fushatë zgjedhore.

Neni 2

Eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor)

Eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) është profesionist i pavarur, i regjistruar sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Neni 3

Përzgjedhja dhe ushtrimi i detyrës

1. Përzgjedhja dhe emërimi i ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë), bëhet në bazë të kriterëve të kualifikimit të përcaktuara në nenin 4 të këtij udhëzimi.
2. Eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) ushtron përgjegjësitë dhe kryen detyrat për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partia politike gjatë vitit kalendarik dhe nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore, në mënyrë profesionale, jo diskriminuese, me paanësi dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.
3. Eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) gjatë periudhës së auditimit nuk mund të kryejë veprimtari apo aktivitete që bien ndesh me qëllimin e auditimit sipas këtij udhëzimi.

Neni 4

Kriteret dhe dokumentet e aplikimit

1. Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjorë), përveç kushteve të përgjithshme të ushtrimit të profesionit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duhet të plotësojnë njëkohësisht edhe kriteret e mëposhtme:
 - a) Të ushtrojnë profesionin e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) për jo më pak se 5 (pesë) vitet e fundit,
 - b) Të mos kenë marrë masa disiplinore në fuqi,
 - c) Të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike në 5 (pesë) vitet e fundit.
 - d) Të mos ketë qenë kandidat i mbështetur nga ndonjë parti politike, koalicion apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit në 2 zgjedhjet e fundit,
 - e) Prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të mos jenë anëtarë i partisë politike objekt i auditimit.
2. Të interesuarit duhet të paraqesin pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në afatin e përcaktuar, dokumentacionin, si më poshtë:
 - a) Kopje të noterizuar të licencës të ekspertit kontabël të licensuar (auditues ligjor), lëshuar nga IEKA, e vlefshme për vitin kalendarik respektiv.
 - b) Vërtetim nga IEKA që vërteton se eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) ka jo më pak se 5 (pesë) vite eksperiencë dhe se nuk ka masë disiplinore në fuqi,
 - c) Fotokopje të dokumentit të identifikimit.
 - d) Deklaratë vetjake se nuk është në kushtet e parashikuara në shkronjat “c”, dhe “d”, të pikës

1 të këtij neni, sipas formatit të miratuar në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

- e) Raport mjeko-ligjor.
 - f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
3. Pas hedhjes së shortit, audituesi vetëdeklaron se nuk është në kushtet e ndalimit të përcaktuar në shkronjën “e”, të pikës 1 të këtij neni.
 4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në fillim të çdo viti kalendarik bën thirrjen publike për të aplikuar për ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve dhe shpenzimeve gjatë vitit kalendarik dhe atij zgjedhor sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr.8580 datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

Neni 5

Verifikimi paraprak

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet strukturës të administratës së KQZ-së përgjegjëse për auditimin e fondeve, brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit, bën verifikimin paraprak të aplikantëve për plotësimin e kriterëve formale në bazë të dokumentacionit të depozituar.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, miraton listën e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjorë) sipas pikës 1 të këtij neni, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit. Përzgjedhja e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) bëhet me short.

Neni 6

Procedura e emërimit

1. Çdo fillim viti kalendarik, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kërkon informacion të përditësuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë për listën e partive politike të regjistruara.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e regjistrimit të partisë politike cakton me short 1 (një) apo më shumë ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjorë) për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik nga partia politike. Në vit zgjedhor, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, emërohen me short një apo më shumë ekspert kontabël të licensuar (auditues ligjorë) nga lista e përzgjedhur sipas nenit 5 të këtij udhëzimi për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore.

3. Hedhja e shortit për caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe zëvendësuesve të tyre organizohet nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së në seancë publike.
4. Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjorë) kanë të drejtë të jenë të pranishëm në hedhjen e shortit. Pas hedhjes së shortit për caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesit ligjorë) vijohet me shortin e përcaktimit të kandidatëve zëvendësues të ekspertëve kontabël të licensuar (audituesive ligjorë) në rast të krijimit të vakancës prej tyre.
5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka të drejtë, me vendim të arsyetuar, të përjashtojë nga procedura e shortit ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjorë) të cilët nuk kanë përmbushur më parë detyrimet kontraktuale me KQZ-në.
6. Në çdo rast, eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) nuk mund të auditojë:
 - a) të njëjtin subjekt zgjedhor për dy zgjedhje radhazi, për auditimin e shpenzimeve në vit zgjedhor;
 - b) të njëjtën parti politike për 2 vite radhazi, për vitin kalendarik.
7. Në vit zgjedhor, bëhen 2 auditime të ndara nga auditues të ndryshëm, për vitin kalendarik paraardhës dhe për auditimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore. I njëjti auditues nuk mund të auditojë të njëjtën parti politike, për shpenzimet vjetore dhe shpenzimet e fushatës.
8. Pas hedhjes së shortit ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjorë) të përzgjedhur nënshkruajnë kontratën me KQZ-në, sipas modeleve të kontratës bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shtojcat 1 dhe 2.

Neni 7

Verifikimi i raporteve të auditimit dhe të dhënave

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet strukturës të administratës së KQZ-së përgjegjëse për auditimin e fondeve, verifikon raportin e auditimit të përgatitur nga ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjorë).
2. Partitë Politike duhet të vënë në dispozicion të ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) të caktuar nga KQZ-ja çdo informacion, dokument apo të dhënë, që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit kalendarik.
3. Subjektet Zgjedhore (partitë politike që garojnë më vete apo pjesë e një koalicioni dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit) duhet të vënë në dispozicion të ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) të caktuar nga KQZ-ja çdo informacion, dokument apo të dhënë, që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e kryera për qëllime të fushatës zgjedhore.

4. KQZ-ja i përcjell ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) të dhëna, informacion dhe dokumentacion, për të cilat vihet në dijeni kryesisht ose nëpërmjet monitoruesve të saj, në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore dhe kryerjen e shpenzimeve prej partive politike dhe/ose kandidatëve të tyre, kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit.
5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kërkon të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t'i përgjigjen kërkesës së tij brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohen administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 8

Shfuqizim

Udhëzimi nr. 8, datë 25.03.2009, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e kriterëve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore dhe auditimin financiar vjetor”, shfuqizohet.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Nr. ____ Prot.

Datë: __. __. 202__

KONTRATË SHËRBIMI PËR AUDITIMIN VJETOR TË PARTIVE POLITIKE

E lidhur sot, më datë __. __. ____, ndërmjet palëve të mëposhtme:

Z./Znj. _____, në cilësinë e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor), me dokument identifikimi nr _____, që më poshtë do të quhet OFRUESI I SHËRBIMIT.

dhe

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,
z. _____ që më poshtë do të quhet POROSITËSI,

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është kryerja e auditimit të detyrueshëm të partitve politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik _____, në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike” i ndryshuar, dhe/ose aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjatë vitit kalendarik pararendës, ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar si dhe ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim te tyre.

Neni 2

Baza ligjore

Dipozitat e kësaj kontratë i referohen ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike” i ndryshuar, udhëzimit nr.14, datë 09.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të

liçensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, si dhe udhëzimit nr.10, datë 21.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyren e pagesës së audituesve”.

Neni 3

Kohëzgjatja e kontratës

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme deri me datë ____ . ____ .202_

Neni 4

Çmimi i shërbimit

1. Ofruesi i Shërbimit do të paguhet në masën 0.3%, në bazë të vlerës të të ardhurave të subjektit të audituar (pa TVSH). Vlera e të ardhurave do të jenë të gjitha hyrjet të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
2. Në rast se çmimi i shërbimit është nën vlerën referuese të pagës bazë minimale mujore në shkallë vendi, përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, audituesi do të paguhet sa paga minimale.

Neni 5

Mënyra e pagesës dhe rregullat e faturimit

1. Pagesa do të kryhet në monedhë shqiptare (Lekë), në llogarinë bankare të ofruesit të shërbimit nr. _____.
2. Për shërbimin e kryer nga Ofruesi i Shërbimit do të lëshohet një faturë tatimore. Fatura duhet të përmbajë:
 - a) llojin e shërbimit;
 - b) emrin e subjektit të audituar;
 - c) shumën e pagesës.
3. Fatura së bashku me dokumentacionin mbështetës do të dorëzohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në subjektin e audituar.
4. Shpenzimet e nevojshme për auditimin e partive politike mbulohen nga vetë partitë politike.

5. Partitive politike, që përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, KQZ-ja u mban nga llogaria e tyre shumën për pagesën e audituesve të raporteve financiare vjetore.
6. Partitë politike, të cilat nuk përfitojnë fonde Buxheti i Shtetit, duhet të transferojnë fondet e nevojshme, në llogarinë bankare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me qëllim pagesën e audituesve. Afati për transferimin e këtyre fondeve duhet të bëhet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga dorëzimi i faturës së lëshuar nga ofruesi i shërbimit.

Neni 6

Detyrat e ofruesit të shërbimit

Ofruesi i shërbimit ka këto detyra:

- a) të kryejë shërbimet e përcaktuara në këtë kontratë;
- b) të kryejë shërbim pranë ambienteve të partisë politike që do të auditojë;
- c) të verifikojë çdo informacion, dokument, llogari bankare apo të dhënë, që ka të bëjë me financimin dhe shpenzimet e kryera nga partitë politike si dhe të marrë deklarata nga drejtuesit e partisë politike që auditon për çështjet që i nevojiten për të kryer shërbimin;
- d) të kryejë auditimin e partive politike nëpërmjet kontrollit të dokumenteve financiare e të llogarive kontabël të partive politike, të subjekteve të lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi me partitë politike;
- e) të depozitohet fizikisht dhe në format elektronik në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin e auditimit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës;
- f) të hartojë raportin e auditimit me profesionalizëm sipas shtojcës nr.3 të udhëzimit nr.10, datë 21.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyren e pagesës së audituesve”, në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike” i ndryshuar, ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.
- g) të mos përfshijë të dhëna personale të dhuruesve nën vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- h) të paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kur i kërkohet, për sqarime të nevojshme, gjatë hartimit të raportit dhe pas depozitimit të raportit përfundimtar.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e porositësit

Porositësi është i detyruar:

- a) t'i njoftojë menjëherë Ofruesit të Shërbimit të dhënat e partisë politike, ku përfshihen:
 - i. Adresa, sipas të dhënave në Regjistrin e Partive Politike të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
 - ii. Emrin/mbiemrin dhe adresën e kryetarit dhe të financierit të partisë, nëse subjekti është parti politike.
- b) t'i njoftojë menjëherë partisë politike të dhënat e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) të përzgjedhur.
- c) të paguajë çmimin përkatës të përcaktuar në nenet 4 dhe 5 pika 4 të kësaj kontrate;
- d) të njoftojë ofruesin e shërbimit me çdo mjet komunikimi për çdo ndryshim të akteve nënligjore që ndikojnë në performancën e tij.

Neni 8

Konfidencialiteti

Ofruesi i shërbimit nuk do të zbulojë asnjë informacion konfidencial në lidhje me partinë politike që ai/ajo do të auditojë.

Neni 9

Komunikimi

1. Palët komunikojnë me njëra tjetrën me shkrim dhe/ose me postë elektronike në adresat e mëposhtme:

a) Adresa postare elektronike e porositësit: _____

b) Adresa postare elektronike e ofruesit të shërbimit _____

2. Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve struktura e ngarkuar për komunikimin dhe mbikëqyrjen e ofruesit të shërbimit është:

Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", nr 4, Tiranë



Neni 10

Ndërprerja e kontratës

1. Nëse ofruesi i shërbimit e përfundon kontratën në mënyrë të njëanshme përpara afatit, ai/ajo nuk do të paguhet.
2. Nëse ofruesi i shërbimit nuk përmbush një nga detyrat e caktuara në nenin 6 të kësaj kontrate, KQZ njofton këtë të fundit gjithashtu edhe partinë politikë për ndërprerjen e menjëhershme të kësaj kontrate pa asnjë penalitet ndaj KQZ-së dhe partisë politike.
3. Në çdo rast, KQZ-ja ka të drejtë të ndërpresë kontratën pa asnjë lloj penaliteti, në rast se Ofruesi i Shërbimit nuk relizon përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara në këtë kontratë apo udhëzimit nr. ____, datë _____.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”.
4. Kur njëra nga palët e kësaj kontrate, nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër, sipas rastiit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, sipas nenit 698 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve që mund të lindin në të ardhmen për zbatimin e kësaj kontrate, palët diskutojnë dhe mundohen t’i zgjidhin ato me mirëkuptim. Në të kundërt, ata i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Neni 12

Dispozita përfundimtare dhe përmbyllëse

1. Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë i vlefshëm vetëm kur bëhet me shkrim/postë elektronike në adresat e përcaktuara në kontratë.
3. Të gjitha shtesat dhe ndryshimet që mund të bëhen në këtë kontratë janë të vlefshme dhe bëhen pjesë e kësaj kontrate vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga palët apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar.



4. Kontrata përpilohet në 4 (katër) kopje, me të njëjtën vlerë juridike dhe pasi konsiderohet e rregullt, nënshkruhet nga të dy palët pa asnjë vërejtje.

Ofruesi i Shërbimit

Porositësi

Sekretari i Përgjithshëm i KQZ

Z./Znj. _____

Z. _____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Nr. ____ Prot.

Datë: __. __. __

KONTRATË SHËRBIMI PËR AUDITIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE

E lidhur sot, më datë __. __. __, ndërmjet palëve të mëposhtme:

Z./Znj. _____, në cilësinë e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor), me dokument identifikimi nr _____, që më poshtë do të quhet OFRUESI I SHËRBIMIT.

dhe

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,
z. _____ që më poshtë do të quhet POROSITËSI,

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është kryerja e auditimit të detyrueshëm, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet _____ të datës __. __. __, nga subjektet zgjedhore (parti politike që garojnë më vete ose pjesë e një koalicioni, kandidat i propozuar nga zgjedhësit), si dhe kandidatë e listave shumëëmërore në përputhje me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.8580 datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, ligjin nr. 10019, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizmin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe Kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe në zbatim të tyre.

Neni 2

Baza ligjore

Dipozitat e kësaj kontratë i referohen ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike” i



ndryshuar, udhëzimit nr.14, datë 09.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, si dhe vendimit nr.13, datë 06.04.2021, të Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Neni 3

Kohëzgjatja e kontratës

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme deri me datë ____ . ____ . ____

Neni 4

Çmimi i shërbimit

1. Ofruesi i Shërbimit do të paguhet në masën 0.3%, në bazë të vlerës të të ardhurave të subjektit të audituar (pa TVSH). Vlera e të ardhurave do të jenë të gjitha hyrjet të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
2. Në rast se çmimi i shërbimit është nën vlerën referuese të pagës bazë minimale mujore në shkallë vendi, përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, audituesi do të paguhet sa paga minimale.

Neni 5

Mënyra e pagesës

1. Pagesat do të kryen në monedhë shqiptare (Lekë) në llogarinë bankare të ofruesit të shërbimit nr. _____.
2. Për shërbimin e kryer nga Ofruesi i Shërbimit do të lëshohet një faturë tatimore. Fatura duhet të përmbajë:
 - a) llojin e shërbimit;
 - b) emrin e subjektit të audituar;
 - c) shumën e pagesës.
3. Fatura së bashku me dokumentacionin mbështetës do të dorëzohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
4. Pagesa do të kryhet me urdhër xhirimi. Porositësi është i detyruar të paguajë çmimin e caktuar në nenin 4 të kësaj kontrate, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e marrjes në dorëzim të faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimit.



Neni 6

Detyrat e ofruesit të shërbimit

Ofruesi i shërbimit ka këto detyra:

- a) të kryejë shërbimet e përcaktuara në këtë kontratë;
- b) të kryejë auditimin nëpërmjet kontrollit të dokumenteve financiare e të llogarive kontabël të subjekteve të audituara, të subjekteve të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me to;
- c) të kryejë shërbim pranë ambienteve të subjektit që do të auditojë;
- d) të hartojë raportin e auditimit me profesionalizëm, sipas shtojcës nr. 4 të vendimit nr. 13 datë 06.04.2021, të Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore” dhe në përputhje me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike” i ndryshuar, ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar”, si dhe ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre;
- e) të verifikojë çdo informacion, dokument, llogari bankare apo të dhënë, që ka të bëjë me financimin dhe shpenzimet e kryera nga subjektet politike dhe kandidatët e listave shumëemërore, si dhe të marrë deklaratat nga drejtuesit e partive politike/kandidatët për çështje që i nevojiten për të kryer shërbimin;
- f) të depozitojë fizikisht dhe në format elektronik në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin e auditimit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës;
- g) të mos përfshijë të dhëna personale të dhuruesve nën vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- h) të paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kur i kërkohet, për sqarime të nevojshme, gjatë hartimit të raportit dhe pas depozitimit të raportit përfundimtar.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e porositësit

Porositësi është i detyruar:

- a) t’i njoftojë menjëherë Ofruesit të Shërbimit të dhënat e subjektit që do të auditojë, ku përfshihen:
 - i. Adresa, sipas të dhënave në Regjistrin e Partive Politike të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
 - ii. Emrin/mbiemrin dhe adresën e kryetarit dhe të financierit të subjektit që do të auditojë.



- b) t'i njoftojë menjëherë subjektit që do të auditohet të dhënat e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) të përzgjedhur.
- c) të paguajë çmimin përkatës të përcaktuar në neneve 4 dhe 5, pika 4, të kësaj kontrate;
- d) të njoftojë Ofruesin e Shërbimit me çdo mjet komunikimi për çdo ndryshim të akteve nënligjore që ndikojnë në performancën e tij.

Neni 8

Konfidencialiteti

Ofruesi i shërbimit nuk do të zbulojë asnjë informacion konfidencial në lidhje me subjektin që ai/ajo auditon.

Neni 9

Komunikimi

1. Palët komunikojnë me njëra tjetrën me shkrim dhe/ose me postë elektronike në adresat e mëposhtme:
 - a) Adresa postare elektronike e porositësit: _____
 - b) Adresa postare elektronike e ofruesit të shërbimit _____
2. Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve struktura e ngarkuar për komunikimin dhe mbikëqyrjen e ofruesit të shërbimit është:
Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", nr 4, Tiranë

Neni 10

Ndërprerja e kontratës dhe penalitetet

1. Nëse ofruesi i shërbimit e përfundon kontratën në mënyrë të njëanshme përpara afatit, ai/ajo nuk do të paguhet.
2. Nëse ofruesi i shërbimit nuk përmbush një nga detyrat e caktuara në nenin 6 të kësaj kontrate, KQZ njofton këtë të fundit për ndërprerjen e menjëhershme të kësaj kontrate pa asnjë penalitet ndaj KQZ-së.
3. Në çdo rast KQZ-ja ka të drejtë të ndërpresë kontratën pa asnjë lloj penaliteti, në rast se ofruesi i shërbimit nuk realizon përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara në këtë kontratë apo udhëzimit nr. ____, datë _____.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara



dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”.

4. Kur njëra nga palët e kësaj kontrate, nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër, sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, sipas nenit 698 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve që mund të lindin në të ardhmen për zbatimin e kësaj kontrate, palët diskutojnë dhe mundohen t’i zgjidhin ato me mirëkuptim. Në të kundërt, ata i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Neni 12

Dispozitat përfundimtare dhe përmbyllëse

1. Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë i vlefshëm vetëm kur bëhet me shkrim/postë elektronike në adresat e përcaktuara në kontratë.
3. Të gjitha shtesat dhe ndryshimet që mund të bëhen në këtë kontratë janë të vlefshme dhe bëhen pjesë e kësaj kontrate vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga palët apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar.
4. Kontrata përpilohet në 4 (katër) kopje, me të njëjtën vlerë juridike dhe pasi konsiderohet e rregullt, nënshkruhet nga të dy palët pa asnjë vërejtje.

Ofruesi i Shërbimit

Porositësi

Sekretari i Përgjithshëm i KQZ

Z./Znj. _____

Z. _____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Shtojca nr. 1

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Deklaruesi

Unë i/e nënshkruari/a _____, në cilësinë e ekspertit/es kontabël të licensuar (audituesit ligjor) me dokument identifikimi nr _____, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon udhëzimi nr. __, datë __.__.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, pasi nuk kam qenë për 5 (pesë) vitet e fundit anëtar i ndonjë partie politike, si dhe për 2 (dy) vitet e fundit nuk kam qenë kandidat i mbështetur nga ndonjë parti politike, koalicion apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit.

Kjo deklaratë është hartuar më të dhënat në ditën e deklaramit.

Kujdes! Deklaruesi mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë.

Data e dorëzimit të deklaratës __.__.__

Deklaruesi

(Emër, Mbiemër, Firmë)

